



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. 505 Prot

Përmet, më 18.02.2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Operatorin ekonomik "**Sofia Myftari**" person fizik

Procedura e prokurimit: *Kërkesë për propozim*

Numri i referencës së procedurës: *REF- 48273-01-27-2020*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *"Blerje ushqime për Çerdhen, Kopshtin me drekë dhe Konviktin në Bashkinë Përmet"*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s'ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X* oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- **Operatori ekonomik "Ferit Myftari" person fizik** me NIPT K32508611I me vlerë të ofertës: 1 144 115 (një milion e njëqind e dyzet e katër mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 1 372 938 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë me TVSH.
- 2- **Operatori ekonomik "Sofia Myftari" person fizik** me NIPT K42611766Q me vlerë të ofertës: 1 118 300 (një milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë pa TVSH dhe 1 341 960 (një milion e treqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë me TVSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori "Ferit Myftari" person fizik**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, operatori "**Ferit Myftari**" person fizik nuk plotëson pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik.

Ky operator **nuk ka dorëzuar asnjë nga dokumentat e kërkuar** për të provuar pasjen në pronësi ose me qera të automjeteve të transportit të përshtatshëm për zërat e mallrave sipas preventivit dhe automjet tip ATV(frigorifer), duke qënë se ky operator bazuar në ekstraktin e QKB-së është në një distancë më të madhe se 2 km nga institucionet që do të furnizohen.

Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Në nenin 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: - a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose –

**c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën**

### **Oferta te kualifikuara:**

- **Operatori ekonomik “Sofia Myftari ”person fizik**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se *operatori ekonomik “Sofia Myftari”person fizik*, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DST të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik “Sofia Myftari” person fizik me adresë Lagjia 18 shtatori godinë 1 katëshe, përballë Fakultetit Ekonomik dhe adresë tjetër Lagjia 18 Shtatori, rruga Reshat Kokalari, objekti nr. 29/23 Gjirokastër* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1 118 300 (një milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.02.2020

**Ankesa: JO**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Alma HOXHA**